

Përmbledhja joteknike
Hapje Konsultim me Publikun
Projekti: Kalekim Neon

Shkurt / 2021
Tiranë, Shqipëria

Pasqyra e lëndës:

1.	Hyrje	4
1.1.	Te dhena te pergjithshme	4
1.1.	Vendodhja e Projektit.....	4
1.2.	Kuadri ligjor dhe politik.....	6
1.3.	Kuadri ligjor per vlerësimin e ndikimit në mjedis	6
2.	PERSHKRIMI I INSTALIMIT/IMPIANTIT.....	7
2.1.	Te dhena te pergjithshme per shoqerine dhe aktivitetin.....	7
2.1.1.	Te dhena per shoqerine.....	7
2.1.2.	Te dhena per aktivitetin qe kryen shoqeria.....	8
2.1.3.	Qellimi i aktivitetit	8
2.1.4.	Pershkrimi i aktivitetit	8
2.1.4.1.	Reparti i paketimit te adeziveve te ngurte (kolle, bojake dhe stuko e patinimit).....	9
2.1.5.	Pershkrimi i hollesishem i instalimeve qe bejne pjese ne linjen e prodhimit te bojrave dhe produkteve te tjera.....	10
2.1.5.1.	Reparti i prodhimit te bojrave disperso-ujore.....	10
2.1.5.2.	Reparti i bojrave disperse	10
2.1.5.3.	Reparti i paketimit te produkteve te gatshme	12
2.1.6.	Reparti paketim, amballazhim, magazinim.....	13
2.1.6.1.	Makinerite dhe pajisjet qe perdoren per paketimin e produkteve qe permendem me lart jane: - 13	
2.1.6.2.	Reparti i paketimit te adeziveve pluhur.....	14
2.1.6.3.	Magazina e lendeve te para dhe produkteve te gatshme	16
2.1.6.4.	Laboratori.....	16
2.1.6.5.	LENDET E PARA	17
3.	PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT	17
3.1.	Te dhena te pergjithshme	17
3.2.	Bashkine Vore	17
3.3.	Ekologjia	18
3.4.	Gjeologjia dhe hidrogeologjia	19
3.5.	Klima	19
3.6.	Sizmiciteti.....	19
3.7.	Gjeologjia dhe Dherat.....	20
4.	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TE RENDESISHME NE MJEDIS	21
4.1.	Metodika e përdorur për vlerësimin e ndikimeve të mundshme në mjedis	21
4.2.	Vlerësimi i rëndësishëm së ndikimeve të identifikuara	21

SHKURTESAT

VNM	Vlerësimi i ndikimit në mjedis
Shpk	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
mw	megawat
AKM	Agjensia Kombëtare e Mjedisit
BE	Bashkimi Europian
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
km	Kilometra
Sh.a	Shoqëri aksionere

1. Hyrje

Vendi yne gjate viteve te fundit ka miratuar nje sere ligjesh dhe vendimesh te Keshillit te ministrave ne fushen e mbrojtjes se mjedisit, duke permiresuar ndjeshem legjislacionin mjedisor dhe social ekonomik te vendit. Gjithashtu gjate kesaj periudhe Shqiperia ka nenshkruar edhe nje sere konventash dhe protokollesh ne klimen e permiresimit te cilesise mjedisore ne vend dhe rajon. Disa prej ketyre konventave te nenshkruara jane:

- Konventa e Aarhus per akses ne informacion, pjesemarrje te publikut ne vendim marrje ambjentaliste dhe akses te drejtesise ne ceshtjet ambjentaliste, te ratifikuar me Ligjin Nr. 8672, date 26 tetor 2000,
- Konventën e Rio De Janeiro-s per Biodiversitetin, te ratifikuar me 10 Nentor 1996,
- Konventa per Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në kontekstin ndërkuftar ESPOO, Finlandë, me 25 shkurt 1991
- Konventa mbi Ndotjen Atmosferike në distanca të mëdha, Gjenevë, Zvicër, me 13 nëntor 1979.
- Konventa për Ruajtjen e Florës dhe Faunes së egër dhe mjedisit natyror të Europës Ne Bernë, 19 shtator 1979. Etj.

Nenshkrimi i nje sere konventash dhe miratimi i kuadrit ligjor per mjedisin dhe ne funksion te tyre, detyron institucionet shteterore dhe subjektet fizike e juridike ti nenshtrohen disa procedurave profesionale para miratimit dhe zbatimit te projektit te tyre.

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) eshte nje prej instrumentave parandalues dhe minimizues te ndikimit mjedisor dhe per projektin specifik, hartohet duke u bazuar ne zhvillimin strategjik te qytetit te Tiranes. Ky raport perfshin vleresimin, identifikimin, e ndikimit te zbatimit te aktivitetit "Perpunimi Mekanik i Llamarines", me vendodhje ne Bexulle, Tirane. Ky raport i VNM-se po pergatitet per qellim informimi te publikut, per aktivitetin qe do zhvillohet ne kete zone.

1.1. Te dhena te pergjithshme

Subjekti "Kalekim Neon" Sh.p.k i regjistruar prane QKR, me NIPT: L919120201, me seli ne Bexulle, Fshati Gjokaj, Tirane do te veri ne funksion aktivitetin "Prodhim bojhe dhe materiale ndertimi" me vendodhje ne Fshatin Gjokaj, Njesia Administrative Bexulle, Bashkia Vore, Qarku Tirane.

Subjekti, per realizimin e projektit te tij do te paiset me te gjitha miratimet perkatese te lejeve te nevojshme per funksionimin e tij.

1.1. Vendodhja e Projektit

Projekti ndodhet ne Fshatin Bexulle, ne Pronen ne Zonen Kadastrale 1167, Nr. Pasurie 706/7 Volumi 9 Faqe 29 i dokumentit te Pronesise dhe ka nje siperfaqe 2460 m².

Projekti Kufizohet :

V Pronen 1010/2

L. Pronen 1011/1

J. Pronen 33

P. Pronen 706/6

HARTA KADASTRALE
(Fragment)

AGJENCIA VENDORE AGJENCISË
SHTETËRORE TE KADASTRËS
KAMËZ-VORE

DREJTOR

ARJON BISTRI



A.IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE 1167 NR.PASURISË 706/7 VOL 9 FQ. 29

INDEKSI I HARTËS K-34-88- (114-D) SHKALLA 1:250

ADRESA PASURISË: Rrethi :TIRANË, Q/F BULEVARDE

Rr/L _____, P/G _____, Sh _____, K _____, Ap _____

B.KUFIZIMET

V. 10.10/1

L. 10.11/1

J. 28

P. 706/6

C.PRONARI

JANI KOLA

BESHNIK FALASI

D.Data: ___/___/2019,

PUNOI: BADARAJ



1.2. Kuadri ligjor dhe politik

1.3. Kuadri ligjor për vlerësimin e ndikimit në mjedis

Shqipëria ka një legjislacion specifik i cili kërkon kryerjen e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Ligji i vitit 2002 për Mbrojtjen e Mjedisit ka përcaktuar kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, përfshirë dhe kërkesën për kryerjen e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe marrjen e lejes mjedisore përpara se të fillojë një projekt. Ai përcakton kërkesat monitoruese për identifikimin e ndikimit që do të ketë një projekt gjatë fazave të ndërtimit, operimit dhe rehabilitimit, si dhe kërkesat gjatë fazës së mbylljes së projektit. Ligji u zëvendësua me ligjin nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, i cili synon të pasqyrojë direktivat e Bashkimit Evropian dhe praktikën më të mira në lidhje me menaxhimin e mjedisit. Ligji i vitit 2011 për Mbrojtjen e Mjedisit (i ndryshuar) përcakton kuadrin ligjor të mbrojtjes së mjedisit, rregulloret dhe kompetencat institucionale, parimet e vlerësimit të ndikimit në mjedis si dhe lejet mjedisore. Ai përcakton aktivitetet që ndikojnë në mjedis, si: "çdo aktivitet ekonomik dhe social që përdor mjedisin ose një pjesë të tij, ose që shkarkon materiale dhe energji duke i ndryshuar karakteristikat e tij".

Kuadri ligjor për procedurën e VNM-së në Shqipëri bazohet në Ligjin Nr. 10440 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", miratuar më 07.07.2011 dhe më pas me Ligjin Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 07.07.2011, Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis "dhe VKM-në nr. 10 448, datë 14.07.2011" Për Lejet Mjedisore", i ndryshuar. Një kuadër i rëndësishëm ligjor për VNM-në është gjithashtu VKM nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", i ndryshuar, dhe VKM nr. 247, data 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".

Table 1. Legjislacioni shqiptar për VNM

Legjislacioni	Përmbledhje	Rëndësia në lidhje me Projektin
Ligji nr. 10431 (09.06.2011) i ndryshuar	"Për Mbrojtjen e Mjedisit: (i ndryshuar) - ky ligj përcakton kuadrin ligjor për mbrojtjen e mjedisit, rregulloret dhe kompetencat institucionale, parimet e vlerësimit të ndikimit në mjedis si dhe lejet mjedisore. Ligji bazohet në parimet e Bashkimit Evropian dhe praktikën më të mira për menaxhimin e mjedisit.	Duhet të kryhet VNM-ja dhe të merret leja mjedisore përpara se të fillohet një Projekt. Ligji përcakton kërkesat monitoruese për identifikimin e ndikimit që do të ketë një projekt gjatë fazave të ndërtimit, operimit dhe rehabilitimit, si dhe kërkesat gjatë fazës së mbylljes së projektit.
Ligji nr. 10440 (07.07.2011) i ndryshuar	"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" (i ndryshuar) - përcakton parimet e një VNM-je, përcakton kategoritë e projekteve me ndikim në mjedis dhe përcakton përgjegjësitë dhe të drejtat e institucioneve dhe publikut në procedurën e VNM-së. Ligji përcakton kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTE) për sa i përket procedurës, shqyrtimit e raportit të VNM-së dhe miratimin përfundimtar të tij.	VNM-ja për Projektin do të dorëzohet në MTM dhe AKM për kontroll, rishikim dhe emiratim.

<p>Ligji nr. 10448 (14.07.2011) i ndryshuar</p>	<p>"Për lejet mjedisore" (i ndryshuar) përcakton kushtet dhe termat e dhënies së lejeve mjedisore për operatorët industrialë dhe përcakton masat për parandalimin dhe kontrollin e shkarkimit të ndotjeve dhe menaxhimin në mënyrë të sigurt të kimikateve. Në përgjithësi, objekti i kuadrit rregullator është: të parandalojë dëmtimin e mjedisit; të garantojë përputhjen me standardet e shëndetit dhe mjedisit dhe mbrojtjen nga çdo detyrim i mbetur.</p>	<p>-Deklarata Mjedisore kërkohet për ndërtimin e hidrocentraleve (të rregulluara sipas ligjit 10440/2011).</p>
<p>Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr.686 (29.07.2015) i ndryshuar</p>	<p>"Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (vnm) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", i ndryshuar - Akti përcakton rregullat specifike dhe të hollësishme për procedurën, kuadrin dhe strukturën e raportit dhe shtojcave të VNM-së, afatin kohor të procedurës, kërkesën për aprovim, vendimin përfundimtar dhe monitorimin e ndikimit dhe raportimin gjatë ekzekutimit të projektit.</p>	<p>Raporti i VNM-së do të përgatitet në përputhje me këtë VKM.</p>
<p>Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 247 (30.04.2014)</p>	<p>"Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore" - Akti përcakton kërkesat specifike për konsultimin me grupet e interesit, duke u fokusuar në konsultimet me komunitetet lokale. Gjithashtu jep detaje mbi procedurën që duhet ndjekur, afatin kohor dhe botimin në media.</p>	<p>Grupet e interesit do të angazhohen / konsultohen gjatë gjithë procesit të VNM-së; një Plan për Angazhimin me Palët e Interesit (PAPI) është zhvilluar dhe zbatuar nga zhvilluesi dhe konsulenti që në fazën fillestare të procesit.</p>

2. PERSHKRIMI I INSTALIMIT/IMPIANTIT

2.1. Te dhena te pergjithshme per shoqerine dhe aktivitetin

2.1.1. Te dhena per shoqerine

Shoqeria "KALEKIM NEON" Sh.p.k me Administratore Znj. Manuela Zajmi prezantimin e vet ligjor e paracjete ne menyre te permbledhur si me poshte:

Eshte e regjistruar ne Qendren Kombeta re te Biznesit me NIPT L91912020I.

Selia e saj ndodhet ne Tirane, Tirane, Vore, Bexulle.

2.1.2. Te dhena per aktivitetin qe kryen shoqeria

Investitori: Kalekim Neon Sh.p.k

Shoqeria ka nje eksperience shumevjecare ne kete fushe, pasi ka vite qe e ka filluar kete aktivitet. Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne fushen e "Prodhim bojra ujore, ambalazhim bojra zmalto, antikorrozive, llage, ngjitesa, tretesa" me logon "KALEKIM NEON" dhe konkretisht:

- Prodhim te bojrave disperso-ujore per perdorim te brendshem dhe te jashtem per qellime arkitekture
- solvent

Ambalazhim i nje game te gjere produktesh qe perdoren ne sektorin e ndertimit, si:

- | | | | |
|---|--------------------------------------|----------------|---|
| o | Bojra me baze uji | 2 000 ton | 0 solvent |
| o | Bojra zmalto: | 200 000 kg/vit | Max 20% White Spirit = 40 000 kg/vit |
| o | Bojra antikorrozive: | 50 000 kg/vit | Max 20% White Spirit = 10 000 kg/vit |
| o | Llage druri me 1 e 2 komponente: | 10 000 kg/vit | Max 20% White Spirit = 2 000 kg/vit |
| o | Vinovil | | 0 solvent |
| o | Astar plastik | | 0 solvent |
| | | | |
| • | Solvente te ndryshem | | 10 000 kg/vit |
| | | | |
| o | PVC per ngjitje materialesh plastike | 1 000 kg/vit | Max 20% White Spirit = 200 kg/vit |
| | o Aditive te betonit, etj. | | 0 solvent |

TOTALI: **62 200 kg/vit**

2.1.3. Qellimi i aktivitetit

Shocieria ka per qellim te realizoje aktivitetin e "Prodhimit te bojrave, llageve ngjitesve, tretesve".

Aktiviteti qe kryen shoqeria "KALEKIM NEON" Sh.p.k eshte prodhimi i bojrave disperso-ujore per perdorim te brendeshem e te jashtem ne mure, fraksionim dhe ambalazhim te nje game te gjere mbuluesish siperfaqesore, si bojra zmalto, bojra antikorrozive, llak druri me nje dhe dy komponente, vinovil, astar plastik, solvente te ndryshem, PVC per ngjitje materialesh plastike, aditivet e betonit, prodhimi i adeziveve pluhura, si kolla dhe bojaka e pllakave dhe stuko patinimi.

Pjesa me e madhe e produkteve vijne te pergatitura, por ne ambalazhe te medha (fuci dhe konteinere plastike). Ne repartin e fraksionimit dhe ambalazhimit kryhet vetem procesi i peshimit dhe konfeksionimit ne kuti plastike ose metalike me sasi te vogla, te gatshme per perdorim nga konsumatorët.

Te vetmet produkte qe prodhohen ne kete aktivitet te shoqerise jane bojrat disperse-ujore dhe adezivet pluhura te kombinuara per qellime perdorimi te ndryshme ne sektorin e ndertimit.

2.1.4. Pershkrimi i aktivitetit

Linja "KALEKIM NEON" eshte instaluar ne objektin ekzistues ne Tirane Bexull Bexull Rruga Fshati - Gjokaj, pasuria me numer 706/6 Z.Kadastrale 1167, Njesia Bashkiake Bexull, Tirane, Shqiperi.

Aktiviteti:

- Prodhim te bojrave disperso-ujore per perdorim te brendshem dhe te jashtem per qellime arkitekture;
- Ambalazhim i nje game te gjere produktesh qe perdoren ne sektorin e ndertimit, si:
 - o Bojra zmalto

- Bojra antikorrozive
- Llaqe druri me 1 e 2 komponente
- Vinovil
- Astar plastik
- Solvente te ndryshem
- PVC per ngjitje materialesh plastike
- Aditive te betonit, etj.

Ne mjediset tashme te ristrukturuara jane krijuar mjediset per te funksionuar keto reparte:

- Reparti i prodhimit te bojrave disperso-ujore per perdorim te brendshem e te jashtem ne mure;
- Reparti i fraksionimit dhe ambllazhimit te nje game te gjere mbuluesish siperfaqesore si bojra zmalto, bojra antikorrozive, llak druri me nje ose dy komponente, vinovil, astar plastik, solvente te ndryshem, PVC per ngjitje materialesh plastike, aditivet e betonit;
- Reparti i prodhimit te ngjitesve pluhur te kombinuar si kolla dhe bojaka e pllakave, stukot e patinimit, etj.

Pjesa me e madhe e produkteve vijne te pergatitura, por ne ambllazhe te medha (fuci dhe konteinere plastike). Ne repartin e fraksionimit dhe ambllazhimit kryhet vetem procesi i peshimit dhe konfeksionimit ne kuti plastike ose metalike me sasi te vogla, te gatshme per perdorim nga konsumatorret.

Te vetmit produkte qe prodhohen ne kete aktivitet te shoqerise jane bojrat disperso-ujore dhe adezivet pluhura te kombinuara per qellime perdorimi te ndryshme ne sektorin e ndertimit. Linja eshte e perbere nga tre reparte te vecanta pune:

- **1. Reparti i prodhimit te bojrave disperso-ujore** nga lendet e para te importuara, ku ne baze te recetes perkatese realizohet prodhimi i produktit te gatshem per konsum. Bojrat e prodhuara ambllazhohen ne kuti te volumeve te ndryshme, sipas kerkeses se perdoruesit.
- **Reparti i paketimit te bojrave** zmalto dhe bojrave antikorrozive, ngjitesve dhe tretesve nga lendet e para qe vijne te gatshme, por ne ambllazhe te medha. Bojrat, ngjitesit dhe tretesit vetem ambllazhohen ne kuti te volumeve te ndryshme, sipas kerkeses se perdoruesit.

2.1.4.1. Reparti i paketimit te adeziveve te ngurte (kollë, bojake dhe stuko e patinimit).

Destinacioni i ketyre produkteve eshte industria e ndertimit, e drurit dhe e hekurit, sipas nevojave te perdorimit.


Numri i punonjesve eshte 43

Konsumi i pergjithshem i ujit .eshte afersisht 10-11 m³ uje/dite

Konsumi energjise elektrike 8200 kw/muaj

Repartet e prodhimit dhe paketimit te bojrave, tretesve dhe ngjitesve kane nje organizim te proceseve te punes, te cilat plotesojne te gjitha kerkesat ligjore per mbrojtjen e mjedisit, etj. Aktiviteti zhvillohet ne ambjente me hapsira te medha, te cilat perdoren edhe per qellime te tjera.

Teknikisht aktiviteti parashikon prodhimin e bojrave disperso-ujore dhe paketimin e nje sere produktesh te tjera qe vijne te gatshme nga importi. Pra, ne keto reparte behet vetem peshimi dhe ambllazhimi i tyre ne sasira me te vogla, pa krijuar mbetje dhe shkarkime te rendesishme ne mjedis. Per keto arsye, aktiviteti qe kryen shocieria "KALEKIM NEON" Sh.p.k duke marre ne shqyrtim teknologjine, proceset e punes dhe instalimet teknologjike te perdorura do te konsiderohet si nje linje prodhimi me kapacitet te vogel.



Nevojat për ujë dhe energji sigurohen dhe plotësohen nga rrjetet e furnizimit ekzistues të zonës. Duhet të përmendet fakti se jemi në një zonë me destinacion aktivitete të ndryshme ekonomike.

2.1.5. Pershkrimi i hollësishëm i instalimeve që bëjnë pjesë në linjen e prodhimit të bojërave dhe produkteve të tjera

2.1.5.1. Reparti i prodhimit të bojërave disperso-ujore

Në këtë repart prodhohen bojrat ujore, hidromatet dhe bojrat plastike. Për realizimin e këtyre prodhimeve përdoren dy miksera me motorra elektrike përkatësisht 10 dhe 30 kW, dhe me kazanet 600 kg secili. Kazanet janë të lëvizshëm, pasi me parë ato furnizohen mbi peshorë me lëndet e para, pastaj zhvendosen në perzieres. Perzierja bëhet me një disk të dhembësuar, i cili krijon shkallën e duhur të perzierjes. Cikli i një përgatitjeje është rreth 2 orë. Në këtë repart punohet 8 orë, dhe në ditë mund të realizohen dy cikle pune për secilin mikser. Pra, kapaciteti prodhues i këtij reparti është:

2 mikser X 600 kg/cikel X 2 cikle = 2 400 kg/8 orë

Prodhimi varet nga kërkesa e tregut për çdo lloj produkti. Realisht, aktiviteti i prodhimit të bojërave mund të përmblihet si më poshtë:

- rendimenti maksimal i arritur (pra, sa është shitja maksimale) është rreth 1 200 kg/ditë, ndërsa
- aftësia ambalazhuese është rreth 600 kg në 45 minuta.

2.1.5.2. Reparti i bojërave disperse

Teknologjia e prodhimit të bojërave disperso-ujore konsiston në formimin e sistemeve të qëndrueshme disperse të pluhurave (pigmente + mbushës) në mjedisin ujor. Proceset baze janë lagësia dhe dispergimi, që arrihen nëpërmjet energjisë mekanike të perzierjes, duke u ndihmuar dhe nga substancat që ulin tensionin sipërfaqësor të sistemit (emulgatorët). Në përgatitjen e bojës shtohen edhe perberës të tjerë me veti të vecanta, si dispergues, stabilizues, antishkumues, filmformues (që përhapen lehtë në sipërfaqe) dhe rehologjike (lëndë me ndikim në viskozitetin e sistemit).

Struktura baze e një formulimi në prodhimin e bojërave ujore për qëllime arkitekturore përbehet nga:

- Ujë
- Aditivet (dispergues, emulgator, stabilizues, antishkumues, filmformues, rehologjik)
- Pigmentet (TiO₂, Litoponi që është një perzierje e ZnS + Ba SO₄)
- Mbushësit (CaCO₃, talk)
- Lidhësi (rezinë a akrilike/polivinilacetat-PVA)

Ne fazën e parë të prodhimit të këtyre llojeve bojërash shtohen në ujë aditivet dispergues, emulgues, stabilizues, antishkumues, konservues dhe rehologjik. Behet tretja e plotë e tyre në ambient ujor dhe arrihet hidratimi i aditivit rehologjik. Kjo fazë zgjat rreth 25-30 minuta.

Ne fazen e dyte shtohet tretesire amoniakore 20% per te krijuar mjedis bazik, qe e kerkon teknologjia e prodhimit. Me tej vazhdohet perzierja per rreth 10 minuta.

Ne fazen e trete, e cila zgjat 30-40 minuta, fillon hedhja e pigmenteve dhe mbushesve. Keto perberes jane te rendesishem, sepse jane pikerisht keto qe ndikojne ne vetite optike te bojës, fuqine mbuluese te saj dhe normen e konsumit. Stabiliteti i sitemit koloidal vihet re ne kete faze, ne te cilen jane shtuar perberesit kryesore. Mund te ndodhe qe te krijohen flokulime dhe precipitate, ne rast se nuk jane hedhur qe ne fazen e pare shtesa e duhur e stabilizatoreve.

Vazhdohet perzierja deri sa arrihet dispergimi i plote ne mjedisin ujor i pigmenteve dhe mbushesit.

Ne fazen e katert shtohen rezinat akrilike ose PVA, qe sherbejne ne formulime te tilla si lidhes te sitemit. Kjo faze zgjat rreth 30-45 minuta.

Pas provave ne laboratorin e prodhimit te parametrave te tille si: viskoziteti, densiteti, fuqia mbuluese dhe koha e tharjes, produkti eshte gati per amballazhim.

Sasia e lendeve te para qe perdoren ne nje cikël prodhimi varion pergjithesisht ne keto viera:

Uje	25.0% pjese/peshe	
Pigment	10.0% p/p	
Mbushes	48.1% p/p	
Lidhes (rezina)	13.4% p/p	
Aditivet e tjere (secili eshte ne % te vogel)		14.5% p/p

Te gjitha lendet e para qe perdoren ne prodhimin e bojrave vijne nga prodhues te njohur europiane si BASF, BAYER, BYK CHEMIE (Gjermani); ELEMENTIS (France); HERCULES (Hollande). Te gjitha lendet e para qe perdoren jane te certifikuar sipas standarteve CE.

Nder lendet e para aditive qe perdoren mund te permenden:

HYDROPALAE A -dispergues: tretesire ujore e poliakrilatit te amonit,

FOAMASTER 8034FA -antishkumues: bojra me emulgatore qe ulin tensionin siperfaqesor te fazave te sitemit,

Hydroxiethylcelulose (C6H10O5) -agjent rehologjik,

Kripera te polifosfatit te natriumit -stabilizues te sitemit, (NaO - [P0₃] — PO₃Na₂)

TEXANOL Ester Alcohol -aditiv filmformues, (2,2,4 — Trimethy1-1,3-pentanediol monoisobutyrate)

Sodium Benzoate (C₇H₅O₂Na) — konservues,

Prevento(D7) (5-chlor-2-iosothianzolin-3-one) — konservues (tretesire ujore e isothiazolines pa formaldehyde).

Ne repartin e prodhimit te bojës eshte instaluar pompa dhe making e mbushjes se bojës. Ne fund te salles ndodhet nje depozite onoksi me 6-8 m³ uje per nevoja te procesit teknologjik, e cila furnizohet nga depozita e madhe 30 m³ qe ndodhet ne oborrin e objektit. Ambientet jane te ndara nga menyra e te konceptuarit si teknologji. Ne te vertete, ato jane te medha e te gjera dhe perdoren edhe per qellime te tjera.


Mbetjet e ngurta: Ne kete repart mund te prodhohet nje sasi e vogel mbetjesh te ngurta, si thase letre, shishe plastike dhe kuti metalike te demtuara, ose difektoze.

Shkarkimet e lengeta: Nga larja e kazanit ne fund te ciklit te punes krijohet nje sasi uji me permbajtje boje, qe perfundon ne nje dekantor te vogel jashte murit te nderteses. Koha e qendrimit te ujrave te shkarkuara ne kete dekantor sherben per precipitimin e lendeve te ngurta, pjese perberese te recetes se bojës, per te siguruar pastrimin e ujrave qe do te shkarkohen ne kanal in e ujrave te kolektorit te objektit, dhe me vone te zones.

Krijimi i pluhurave: Ne momentin e hapjes se thaseve te TiO₂ dhe CaCO₃ dhe te hedhjes se tyre ne kazanin e mikserit, mund te krijohet pak pluhur, por kjo sasi varet nga veprimet e operatorit. Salla e ketij reparti eshte

me kubature te madhe dhe teper e shtrire. Ajo lidhet me ambjentet e tjera te objektit nepermjet ha pesirave te gjera.

SKEMA TEKNOLOGJIKE E REPARTIT TE BOJRAVE DISPERSO-UJORE



2.1.5.3. Reparti i paketimit te produkteve te gatshme

Ne repartin e paketimeve behet ambllazhimi i produkteve te gatshme qe vijne nga importi me ambllazhe te medha, si fuci 150-200 kg dhe konteinere plastike 1 tonesh. Keto produkte importohen nga Greqia dhe Italia, dhe ne kete repart behet fraksionimi ne njesi te vogla ambllazhi, te perdorshme lehtesisht nga konsumatori.



2.1.6. Reparti paketim, ambalazhim, magazinim

Produktet qe ambalazhohen jane:

- **W-S (white spirit)** - ne perberje te te cilit ka komponime volatile alifatike, me nje perqindje te caktuar ka perberes aromatike.
- **Aceton ($CH_3CO CH_3$)** - tretes organik i grupit te ketoneve. Sherben si tretes per llacjet. Ambalazhohet ne kuti metalike 1 000 ml.
- **Diluent** - perzierje tretesish. Perdoret si tretes per bojën zmalto. Ambalazhohet ne kuti metalike 1 000 ml.
- **Pastat pigmentuese** - sisteme disperse-ujore me perqendrim te larta te pigmenteve inorganike, me ngjyra te ndryshme, te cilat sherbejne per ngjyrosjen e bojës së bardhe. Vijnë me fuci 130 kg dhe ambalazhohen ne kuti plastike 0.5 dhe 1.0 kg.
- **Bojrat zmalto, antikorrozive, llak druri** - sisteme disperse me solvente dhe pigmente te ndryshme qe sherbejne per mbrojtjen dhe zburkimin e siperfaqeve metalike dhe te drurit. Ambalazhohet ne kuti metalike 0.5 dhe 1.0 kg.
- **Poliuretane** - sisteme me baze solventesh qe formojne filmin (2 komponentesh) (mbulim sa me te holle te siperfaqes qe lyhet) nga bashkeveprimi i dy komponenteve (polyester A + ngurtesues B qe eshte perzierje tretesish). Ambalazhimi ne kuti metalike 0.5; 1.0; 2.0; 4.0; 8.0 dhe 16 liter.
- **Vinovil, Astar Plastik** eshte emulsion i vinilacetatit (monopolimer). Perdoret si ngjites i drurit, letres dhe ne adezivet per muret dhe tavanet. Ambalazhohet ne kuti plastike 1.0; 5.0 kg.

Lendet e para vijnë ne bidona plastike 50 kg, fuci plastike 130 kg, fuci metalike 180 kg dhe konteinere plastike 1 ton. Ambalazhet e fraksionimit jane te ndryshme, prej plastike dhe kuti metalike. Ambalazhet 0.5; 1.0; 2.0 dhe 4.0 kg stivosen ne kuti kartoni.

2.1.6.1. Makinerite dhe pajisjet qe perdoren per paketimin e produkteve qe permendem me lart jane:

- Kompresori tip M4S, me keto karakteristika:
 - kapaciteti prodhimit te ajrit 5.92 m³ ajer/minute
 - presioni 13 bar
 - tensioni 380 V
 - zhurma qe leshon 72 dBa
- Makine pneumatike per mbushjen e pigmenteve
- Makine pneumatike per mbushjen e vinovilit dhe astarit plastik
- Tre tavolina me pajisje te thjeshta per mbushje me dore te tretesve dhe ngjitesve

Rendimenti i mbushjes se lengjeve te gatshme me makine pneumatike eshte afersisht 1 200 kg/8 ore.

Ndersa mbushja me dore e lengjeve te tjera qe u permenden me lart arrin 500-600 kg/8 ore.

Gjate procesit te fraksionimit rezultojne si mbetje ambalazhet e medha: bidona, fuci dhe konteinere te cilat mund te riperdoren. Mund te qellojne edhe ambalazhe te vogla plastike dhe metalike me difekt, te cilat hidhen si mbeturina.





Salla e ambalazhimit eshte e madhe dhe shume e larte. Ajo eshte e hapur dhe komunikon gjeresisht me sallat e tjera. Ky fakt ben te mundur qarkullimin e bollshem te ajrit, duke mos lejuar te krijohen perqendrim te medha te avujve te solventeve ne ajrin e mjediseve te punes. Punetoret punojne me mjete mbrojtese, si doreza, maska dhe syze mbrojtese.

SKEMA TEKNOLOGJIKE E REPARTIT TE PAKETIMIT TE LENGJEVE TE GATSHME



BOJRY - LLAQE - SHTUESA - TRTESA
IMPORT - PROJEKTI - SHPERNDARJE

REPARTI I PAKETIMIT TE LENGJEVE TE GATSHME



Legjenda :

- 1.- Kompresori
- 2.- Makine mbushese pigmentesh
- 3.- Makine mbushese e vinovilit dhe starit plastik
- 4.- Tavolina pune per mbylljen e kapakeve te kutive
- 5.- Tre pozicione per mbushjen me dore te disa tretsawe te tjere

2.1.6.2. Reparti i paketimit te adeziveve pluhur

Ne teknike dhe sidomos ne ndertim perdoren sasira te medha materiali lidhes. Ato jane lende minerale qe duke u perzier me uje formojne nje brum plastik, i cili mbas nje fare kohe eshte ne gjendje te ngurtesohet.

Kjo yeti e substancave ose e lendeve lidhese, perdoret per te pergatitur betone dhe llace ndertimi, duke perzier materia let lidhese me mbushes te ndryshem, si rere, zhavorr te trashe dhe te holle, etj, ne prezence te ujit.

Ne baze te destinimit dhe te cilesive substancat apo lendet lidhese ndahen ne 3 grupe:

1. **Lidhesit ajrore**, qe ngurtesohen dhe ruajne qendrueshmerine ne ajer. Ne lidhesit ajrore hyjne:

- gelqere ajrore,
- gipsi i ndertimit (allcija),
- lidhes me magnezit dhe dolomit,
- F cemento anhidrite, etj.

Keto materiale perdoren per pergatitjen e llaceve per ndertim dhe suvatim, te artikujve te ndertimit dhe arkitekture e dekorative (allcija, lidhesit manjezial, etj).

2. Lidhësit hidraulike, që ngurtësohen dhe ruajnë qëndrueshmërinë e tyre në ujë. Substancat lidhëse hidraulike kanë rëndësi jashtëzakonisht të madhe dhe janë shumë më të përhapura se sa lidhësit ajrorë.

Ato përdoren:

- në përgatitjen e betoneve dhe beton armëve (beton me armaturë hekur),
- për konstruksionet mbಿತokesore dhe nëntokesore, veprave hidroteknike, rrugëve, urave, etj.

3. Lidhësit antiacid, që mbas ngurtësimit i gëndrojnë veprimin e acideve minerale.

Substancat lidhëse përdoren shumë në ndërtim për të lidhur midis tyre materialet e zakonshme të ndërtimit, si tulla, gurë, etj, si dhe produkte të tjera të cilat shërbejnë me pas si materiale ndërtimi (elemente të parafabrikuara, etj.)

Reparti i prodhimit të adeziveve pluhur ndodhet në pjesën lindore të objektit, i ndarë nga a mbjentet e prodhimit të bojës dhe të paketimeve të produkteve të tjera. Aty do të prodhohen dhe ambalazhohen këto produkte:

- Kolle pllakash
- Bojake pllakash
- Stuko patinimi

Formulimi i këtyre produkteve është i thjeshtë dhe i njëjte përbërës për të tre produktet. Për secilin produkt ndryshimi është në raportet në përqindje të përbërësve të recetes. Pra këto produkte kanë këto përbërës:


- Rerë (SiO_2)
- Gur gelqeror I bluar (CaCO_3)
- Gelqerë e pashuar (CaO)
- Agjente reholgjik (metilhidroksiethylcelulose) Pigmente (okside të hekurit)
- Largues të ajrit (polimere të silanit)
- Lidhës (PVA-Polivinilacetate ose Rezine akrilike)
- Lëndet e para vijne në thasë 25 kg (CaCO_3 , CaO), në konteinere 1 ton ose rifuxhio.

Në mullirin me rrulla do të shkruftohet, ose bluhet rera dhe gelqerja. Me pas, këto bashkë me përbërësit e tjerë hidhen nën perzierësin me shnek, ku behet homogjenizimi i perzierjes së ngurte. **Kapaciteti i këtyre makinerive është 500 kg/dite.** Procesi është i thjeshtë dhe punimi behet në kushte gjysem të thata, për arsye të lidhësit që është në gjendje të lenget. Prandaj emetimi i pluhurave në ambientin e punës mendohet të jetë minimal. Ambalazhimi behet në thasë plastike 25 kg. Mbetjet që krijohen janë thasët e letres dhe mbetjet plastmasi.

Gjithashtu në funksion të shërbimeve të ndryshme të furnizimit të lëndëve të para, të transportit të brendshëm në repart, dhe të shpërndarjes së produkteve të gatshme, shocieria "KALEKIM NEON" Sh.p.k disponon këto mjete e pajisje të tjera:

- Trajlëra 3 cope
- Kamiona 2 cope
- Furgona 3 cope
- Pirun ngrites 1 cope
- Karroca reparti 5 cope
- Transpaleta dore 1 cope

SKEMA TEKNOLOGJIKE E REPARTIT TE PAKETIMIT TE ADEZIVEVE PLUHURA



2.1.6.3. Magazina e lendeve te para dhe produkteve te gatshme

Magazina e lendeve te para eshte e konceptuar vecan nga repartet e prodhimit. Ajo ndodhet brenda sallave te medha te objektit qe pershkruam me lart. Fucite me bojra te gatshme, solvent, ngjitesa, etj. ruhen ne nje vend te fresket, te vecante dhe te siguruar. Ne dispozicion te masave te mbrojtjes nga zjarri jane instaluar 5 fiksa me shkume, 1 me gaz dhe 2 hidrante. Ne

lendet e para perfshihen:

Fuci plastike	130 kg,
Fuci metalike	180 kg,
Bidona plastike	50 kg,
Konteinere plastike	1 ton.

2.1.6.4. Laboratori

Laboratori i prodhimit eshte nje sektor i rëndesishem i linjes se prodhimit. Ai eshte organizuar ne sherbim te prodhimit, per te matur karakteristikat fizike te bojës se pergatitur ne repartin perkates. Ne te ardhmen synohet qe laboratori te jete ne gjendje te kryeje edhe analizat e lendeve te para.



Procesi i prodhimit dhe laboratori drejtohen nga dy specialiste kimiste.

2.1.6.5. LENDET E PARA

- Bojra zmalto 160 kg/vit
- Bojra antikorrozive 40 ton/vit
- Llaqe druri 8 ton/vit
- Solvente te ndryshem 10 ton/vit
- PVC 8 ton/vit
- Aditive betoni 150 ton/vit
- Energji elektrike me kontrate te rregullt me OSSHEE: rreth 8200 kW/muaj
- Karburant per automjetet e transportit: rreth 130 lit nafte ne dite

3. PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT

3.1. Te dhena te pergjithshme

Aktiviteti ne vleresim ndodhet ne Fshatin Bexulle, Njesia Administrative Bexulle, Bashkia Vore, Qarku Tirane

3.2. Bashkine Vore

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Vorës shtrihet në Shqipërinë qendrore dhe kufizohet në veri me bashkinë Krujë, në lindje me bashkinë Kamëz, në jug me bashkinë Tiranë, në jug-perëndim me bashkinë Shijak dhe në lindje me bashkinë Durrës.



Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Vorë ka 25,511 banorë ndërsa sipas Regjistrimit Civil ka 36,230 banorë. Me një sipërfaqe prej 82.72 kilometrash katrore, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të censurit është 308 banorë km² ndërsa sipas Regjistrimit Civil, densiteti është 438 banorë km².

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Censur 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Tiranë	Qyteti Vorë	Vorë	Qyteti Vorë, Fshatrat; Vorë, Marqinet, Shargë, Gerdec, Gjokaj, Kuc, Marikaj, Picar	25,511	36,230	82.72
		Prezë	Fshatrat; Prezë, Ahmetaq, Palaq, Fushë Prezë, Gjeç- Kodër, Ndërmjetës, Breg - Shkozë			
		Bërxullë	Fshatrat; Bërxullë, Mukaj, Domje			

Bashkia e re përbëhet nga tre njësi administrative të cilat janë Vorë, Prezë dhe Bërxullë. Në këtë bashki ka një qytet dhe 18 fshatra. Të gjitha janë njësi përbërëse të rrethit Tiranë, qarku Tiranë.

Bashkia e re e Vorës shtrihet në kryqëzimin kryesor rrugor të Shqipërisë ku lidhet Tirana me Durrësin dhe veriu me jugun e vendit. Për rrjedhojë, në territorin e kësaj bashkie janë vendosur një pjesë e rëndësishme e industrisë së lehtë dhe të ndërtimit ndërsa bujqësia është përqendruar në disa produkte me vlerë të lartë të shtuar si lulet. Në Bashkinë e Vorës janë të regjistruara mbi 800 biznese të mëdha.

Në ish-komunën Prezë gjendet një kala mesjetare e cila përbën në resurs të vogël turistik.

Vora dhe tri njësitë përbërëse kanë parë rritje të shpejtë të popullsisë përgjatë 25 viteve të fundit, gjë që ka sjellë edhe një numër të konsiderueshëm ndërtimesh jashtë planeve urbanistike dhe pa infrastrukturë.

Rritja e konsiderueshme e popullsisë së zonës gjatë 25 viteve të fundit nuk është shoqëruar me investimet e nevojshme në infrastrukturë për t'i shërbyer popullsisë ndërkohë që ndërtimet e shumta pa kriter e kanë vështirësuar më tej ndërtimin e infrastrukturës. Për rrjedhojë, mirëmenaxhimi i burimeve ekonomike aktuale dhe ndërtimi i infrastrukturës, përfshirë furnizimin me ujë dhe kanalizime janë sfidat kryesore.

Hartimi i një plani të qartë zhvillimor mund të ndihmojë në përqendrimin e ndërtimit dhe fabrikave në zona të caktuara duke lehtësuar ndërtimin e infrastrukturës dhe duke kursyer tokën bujqësore. Mirëmbajtja e infrastrukturës së vaditjes për zonat bujqësore është shumë e rëndësishme për banorët e kësaj bashkie krahas sistemit të transportit publik drejt Tiranës dhe Durrësit.

3.3. Ekologjia

Rajoni i Tiranës ka një gamë të gjerë flore dhe faune; ekzistojnë rreth 1600 specie bimësh me përqindje të lartë në raport me sipërfaqen e rajonit. Flora e zonës është e pasur me pemë të tilla si lisi, ahu, pemë halore, si dhe pemë frutore si hurma, kumbulla, shega, mana, kajsia e rushi e shumë bimë të tjera dekorative.

Përveç shkarjes së tokës, shkatërrimi i pyjeve nuk do të thotë vetëm humbje pemësh, por edhe humbje e diversitetit si pasojë e humbjes së zonave të habitatit dhe të zonave ushqyese.

Ne zonen ne fjale ekziston bimesi e kultivuar nga vete banoret e zones. Peme te tilla si hurma, ullinj, Vreshta, zarzavate e perime. Prane kesaj zone kalon edhe lumi I Tiranës I cili e pasuron kete zone me flore dhe faune. Ky lum ndodhet 1.5 km larg ne vije ajrore nga banesa 1-kateshe.

3.4. Gjeologjia dhe hidrogjeologjia

Tirana shtrihet mbi shtresëzime dhe xhepa kuaternari. Ato janë shtresëzime aluviale përgjatë rrjedhës së dy lumenjve kryesorë. Disa brezare më të vjetra lumore janë të përbëra nga zhavorr, gurë ranor e baltë argjilore.


Tirana shtrihet në një shtresë ujë-mbajtëse me përmbajtje poroze, që është pjesërisht arteziane. Uji i nëndheshëm gjendet kryesisht në pjesën perëndimore të qytetit dhe përdoret si për furnizimin publik me ujë dhe për përdorime private, veçanërisht për industrinë.

Puset janë mjaft të cekët, rreth 15 metra të thellë, gjë që i ekspozon ato më shumë ndaj ndotjes nga aktivitetet në sipërfaqe.

Të territorin e Tiranës gjenden disa vendburime qymyrguri të pashfrytëzuara, ndërsa aktiviteti më i përhapur sa i përket shfrytëzimit të burimeve natyrore është përpunimi i gurit për ndërtim dhe atij dekorativ.

3.5. Klima

Në rajonin e Tiranës mbizotëron një klimë nëntropikale-mesdhetare me rreshje dimërore dhe me temperatura mesatare vjetore në korrik + 24° Celsius dhe në janar +7° Celsius. Në vit bie 1 189 mm shi.



Burimi BBC Weather Service

3.6. Sizmiciteti

Trualli Shqiptar vendoset gjate kufirit te perplasjes se dy pllakave te medha qe levizin njera kunder tjetres; pllakes Euroaziatike dhe asaj Arabo-afrikane, dhe eshte vater e perqendruar termetesh e cila preket me shpesh nga termete demtues.

Tirana si shume zona te tjera te vendit eshte zone e prekur nga termetet, ku nga pikepamja sizmoteknike zona mund te goditet nga termete me magnitudo Mmax=5.5-6.0 grade Richter me intensitet deri ne 7 balle MKS-64 e cila shkakton çarje ne mur dhe rrezim te copave te suvash por per objektet e uleta nuk parashikohen shqetesime. Si dhe mundesite per te goditur termetet me shume balle jane te vogla rreth 20%.

3.7. Gjeologjia dhe Dherat

Shqiperia si formacion gjeologjik eshte pjese perberese e rrudhosjeve alpino-mesdhetare pjese e degezimit Dinaro-albano-Helenid, ku ne bejme pjese tek Albanidet. Tirana si zone e jashtme ben pjese ne Ultesiren Paramalore, dhe ndodhet ne krahinen e ultesires perendimore , dhe karakterizohet nga shkembinj te dobet qe i ben te paqendrueshem nga rreshqitja dhe eshte pjese e sistemit neogjenik argjila, konglomerat ranor.

4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TE RENDESISHME NE MJEDIS

4.1. Metodika e përdorur për vlerësimin e ndikimeve të mundshme në mjedis

Çdo aktivitet që zhvillohet në mjedis shoqërohet me pasoja dhe ndikime në të, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jonë ka zgjedhur për t'u zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe më analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer. Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasojë e veprimtarisë bëhet duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur për ndërtim, mënyrën e funksionimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha këto në kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Bazuar në llojin e projektit të propozuar ndikimet më thelbësore mund dhe duhet të analizohen sipas dy fazave të veprimtarisë:

- në fazën e ndërtimit të Objekteve
- në fazën e funksionimit

Është e rëndësishme të kuptohet natyra e këtyre proceseve dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte ose indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve. Duke analizuar edhe shtrirjen në kohë të këtyre ndikimeve, ato klasifikohen në: □ Ndikime të kthyeshme në mjedis

- Ndikime të pakthyeshme në mjedis

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizim e proceseve të natyrës dhe rigjenerim të ekosistemit.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtme:

- njohja me projektin dhe fazat e zbatimit të tij,
- njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis,
- njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes,
- konsultimi me dokumente ligjorë e administrativë dhe raporte të VNM për veprimtari të njëjta.

4.2. Vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve të identifikuara

Për të përcaktuar më mirë masat për kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve negative të identifikuara gjatë procesit të VNM-se dhe për të ndihmuar vendimmarrjen e organeve kompetente, në këtë paragraf është bërë një kategorizim i rëndësisë së çdo ndikimi të mundshëm negativ në mjedis të projektit. Ky kategorizim është kryer bazuar në vlerat mjedisore të zonës, legjislacionin mjedisor në fuqi dhe njohuritë mbi teknologjinë dhe teknikën e kryerjes së operacioneve ndërtimore.

Mjedisi ndikuar	Ndikimi	Shpjegim
Pejsazhi	Ndryshim i pejsazhit të zonës	Do të jete evident prania e këtij impianti buze rruges. Duke qene se eshte nje ndertese ekzistuese ai nuk vleresohet si nje ndryshim rrenjesor i pejsazhit.
Toke	Ngjeshje e tokes	Ngjeshje e tokes nga levizjet e makinerive te renda per instalimin e impiantit.

		Nuk pritet te kete ndikim ne strukturen e tokes perreth zones se aktivitetit..
	Erozion i tokes	Nuk vleresohet te kete erozion te tokes si rezultat i vendosjes se impiantit. Erozioni mund te ndodhe si rezultat i faktoreve atmosferik.
	Ndotje e tokes	Gjate fazes se instalimit mund te kete rrjedhje aksidentale te hidrokarbureve te mjeteve te transportit. Gjate fazes se funksionimi te impiantit nuk parashikohet ndotje te tokes.
Uje	Ndotje e ujerave siperfaqesor	Gjate fazes se instalimit mund te kete rrjedhje aksidentale te hidrokarbureve te mjeteve te transportit te cilat mund e shkaktojne ndotje te ujerave siperfaqesore. Qellimi i impiantit eshte te trajtoje ujrat e ndotura teknologjike brenda normave te VKM 177 date 31/03/2005 dhe ti shkarkoje ne mjedisin ujor prites.Megjithate evidentohet keto raste:
	Ndotje e ujerave nentokesore	Ne rast avarie teknologjike mund te kemi rrjedhjet te cilat depertojne ne shtresat e tokes dhe mund te arrijne ne ujerat nentokesore.
Ajer	Emisione gazesh	Emisione gazesh gjate aktivitetit do te kemi ne disa veprimtari. Perdorimi i gjeneratorit. Mjetet e transportit
	Aromat	Gjate fazes se instalimit te impiantit nuk kemi aroma. Gjate fazes se funksionimit, nuk do te kemi aroma.
	Zhurme, vibrime	Funksionimi i impiantit do te shoqerohet me zhurma te cilat jane brenda nivelit te caktuar: Zhurma do te gjenerohet dhe nga stacioni i pompomit. Gjeneratori vetem ne rastet e nderprerjes se energjise.
Mjedisi biologjik	Flora dhe fauna	Do te kemi shqetesim te faunes nga zhurmat dhe aromat duke sjelle largimin e tyre nga kjo zone. Vlen te theksohet se nuk ka ndonje specie me rendesi te vecante.
Mjedisi human	Shqetesim te banoreve te zones	Do te kete shqetesim te banoreve nga stacioni i pompimit dhe gjithashtu aromat.
Menaxhimi i mbetjeve	Ndikim ne mjedisin e zones	Mbetjet qe do te gjenerohen nga aktiviteti i shoqerise vleresohet te jene minimale.
Ndikimet tjera te projektit	Ndikimet ne trafik	Zona nuk ka fluks te madh trafiku. Aktiviteti mund te ndikojne ne shtimin e trafikut te zones por megjithate ne nivele te pakonsiderueshme.
	Konsumi i energjise	Energjia qe do te perdoret eshte energjia elektrike. Gjeneratori qe funksionon me djegie te naftes do te perdoret vetem ne raste nderprerje energjie.

	Siguria dhe ndikimet ne shendet	Punonjesit para se te punesohen i nenshtrohen nje vizite mjekesore dhe me pas pajisen me nje libreze shendetesore e cila leshohet nga Drejtoria e Shendetit Publik. Investitori ka ne stafin e tij dhe nje mjek patolog i cili realizon konsulta periodike.
	Ndikime social- ekonomike	Rritje e punesimit ne nivel lokal dhe rajonal, rritje e te ardhurave te popullsisë se zones nga punesimi, rritja e eksporteve te produkteve vendase dhe rritja e nivelit te taksave qe paguan shoqeria.

4.3. Plani i Menaxhimit të Mbetjeve

Qëllimi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve (PMM) është të shmangë, zvogëlojë dhe / ose kontrollojë ndotjen në zonat e punës dhe perreth si rezultat i gjenerimit të mbetjeve, i cili më pas mund të shkaktojë ndotje në ajër, ujë, tokë, burime natyrore, etj. dëmtim të florës, faunës dhe çështje të shëndetit të njeriut. Plani përshkruan procesin e ndarjes, trajtimit, deponimit, transportimit dhe deponimit të llojeve të ndryshme të mbeturinave, materialeve dhe produkteve të krijuara gjatë ndërtimit dhe aktiviteteve operative të aktivitetit.

Menaxhimi i dobët i mbeturinave mund të rrisë rrezikun e ankesave / ankesave lokale, rrezikut të shoqëruar me shëndetin e komunitetit dhe punonjësve, rrezikun e ndotjes së mjedisit, publicitetit të keq dhe dëmtimit afatgjatë në reputacionin e kompanisë.

Në mënyrë të veçantë, ky plan përfshin pikat e mëposhtme:

- Llojet e mbetjeve që do të gjenerohen gjatë operimit të subjektit;
- Mbetjet urbane
- Mbetjet metalike
- Llojet e tjera të mbetjeve
- Lista e kompanive të riciklimit për kategori të ndryshme të mbetjeve, për të trajtuar mbledhjen, transportin, riciklimin / trajtimit dhe depozitimin e mbetjeve.
- Përcaktimi i vendeve të depozitimit të mbetjeve, koshave / kontejnerëve dhe sinjalizimit të duhur për identifikimin e zonave dhe mbetjeve, sipas llojit përkatës;
- Masat e hollësishme për menaxhimin e mbetjeve;
- Masat e monitorimit për menaxhimin e mbetjeve;
- Forma e transferimit të mbetjeve;
- Forma e regjistrimit të sasive të mbetjeve, sipas kategorisë së mbetjeve;
- Rekomandime të ndryshme të bazuara në praktikat kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Praktikave specifike të punës për punonjësit dhe ofrimi i trajnimeve në lidhje me bisedimet spontane për menaxhimin e mbetjeve.

Kushtet e përgjithshme në vendodhjen e instalimit janë shumë të mira këtë e dëshmojnë dhe fotot e treguara më poshtë për secilin aktivitet. Subjekti nuk ka pasur raste historike të ndotjes. Siç është përmendur dhe më sipër, subjekti në fjalë nuk gjeneron shkarkime në mjedisin e jashtëm.

Të gjitha aktivitetet e nevojshme të servisit kryhen brenda ambienteve të brendshme. Aktualisht nuk vlerësohet ndonjë aktivitet me ndikime të qënësishme me shtrirje hapësinore në mjedis, kjo për vetë faktin se nuk ka shkarkime të dëmshme në ajër, ujë apo tokë.

5. Monitorimi i planifikuar

Monitorimi i mjedisit është detyrim ligjor, mënyra, frekuenca dhe elementët e monitorimit janë të ndryshëm për veprimtari të ndryshme. Në këtë raport janë paraqitur elementët që duhet të monitorojë subjekti gjatë funksionimit të tij. Elementët e tjerë apo përcaktimi i frekuencave të monitorimit do të përcaktohen në akt miratimit dhe lejes mjedisore për këtë veprimtari. Subjekti aktualisht monitoron të gjithë parametrat në bazë të ligjit për mbrojtjen e mjedisit, të cilat janë përmendur edhe në tabelat dhe paragrafet më sipër.